



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2024

VENDIM

Nr. 179, datë 03.04.2024

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRSHPEJTUAR TË DETYRUAR TË
VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL PERIUDHA E VLERËSIMIT VITI
KALENDARIK 2022 PËR GJYQTARET {...} DHE {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat a) dhe ë) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 61, pika 1, 63 dhe 86, shkronja dh), të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, pas verifikimit të tre kritereve të kandidimit për gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e shpallura me vendimet nr.239, 240, 242, 243, 244 dhe 247, datë 24.05.2023, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe mbas shortit të realizuar,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022, për gjyqtaret znj. {...} dhe znj. {...} Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:
 - Për gjyqtaren znj. {...}– Relatore znj.Irena Plaku - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. {...};
 - Për gjyqtaren znj. {...}- Relatore znj.Emona Muçi - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR